# Kolegji UBT Ferizaj

# Plani Strategjik i Hulumtimit Shkencor dhe Inovacionit 2025-2030

# 1.HYRJE

Plani strategjik për hulumtime shkencore dhe inovacion në Kolegjin UBT dega në Ferizaj 2025-2030, ka për qëllim të paraqes misionin,vizionin dhe objektivat e Kolegjit të cilat duhet të plotësohen në mënyrë që ti përgjigjemi sfidave dhe problemeve bashkëkohore e të cilat kërkojnë zgjidhje të qëndrueshme shkencore dhe inovative në mësimëdhënie,mësimënxënie dhe aplikimin e këtyre njohurive në industri dhe fusha të tjerat në përputhje me programet studimore që ofron Kolegji UBT përfshirë edhe degën në Ferizaj të cilat janë të nevojshme për shoqërinë. Strategjia e hulumtimeve shkencore dhe inovacion do të vendos objektivat që të cilat synon Kolegji UBT dega në Ferizaj. Nëpërmjet kësaj strategjie Kolegji UBT përfshirë edhe degën në Ferizaj do të synon jo vetëm të rris veprimtarinë hulumtuese-shkencore inovative brenda institucionit, por gjithashtu të kontribuoj në komunitet në përgjithësi, nëpërmjet zgjidhjeve shkencore dhe inovative të cilat do të lehtësojnë jetën e shoqërisë. Sigurisht se objektivat e synuara të Kolegjit UBT përfshirë edhe degën në Ferizaj, nuk mund të arrihen pa një strategji të mirëfilltë, pa staf të përkushtuar, pa një bashkëpunim të mirëfilltë me institucine kombëtare dhe ndërkombëtare,industrinë dhe të gjithë akterët tjerë të cilët përfshihen në këtë proces. Kolegji UBT përfshirë edhe degën në Ferizaj ka zhvilluar Planin Strategjikë 2025-2030, i cili parasheh ngritjen e kapaciteteve në hulumtime shkencore dhe inovacion. Në kuadër të Planit Strategjik të Kolegjit, është paraparë objektiva strategjike "Zhvillimi i Hulumtimit, Inovacionit dhe Përgjegjësisë Sociale" e cila më pastaj është zhvilluar në objektiva specifike:

- Rritja e pjesëmarrjes së stafit akademik dhe studentëve në avancimin e shkencës, teknologjisë dhe inovacionit
- Rritje e pjesëmarrësve me kualifikime të avancuara në fushën e shkencës dhe inxhinierisë.
- Rritja e outputeve për njohuritë relevante që i përgjigjen tregut dinamik të punës.
- Krijimi i grupit të përbashkët ndërkombëtar për rritjen e ndikimit të studiuesve vendor.
- Përmirësimi i infrastrukturës ekzistuese dhe zhvillimi i infrastrukturës së re për të mbështetur hulumtimin shkencor.

Plani strategjik për hulumtime shkencore dhe inovacion është në harmoni të plotë me Vizionin dhe Misionin e Kolegjit UBT përfshirë edhe degën në Ferizaj dhe me Planin Strategjik të Kolegjit UBT përfshirë edhe degën në Ferizaj 2025-2030.

## 1.1 RRETH KOLEGJIT UBT

Kolegji UBT pèrfshirè edhe degèn nè Ferizaj ofron një mjedis akademik dinamik dhe inovativ të shekullit të 21-të. Kolegji ofron një mundësi mbështetëse dhe sfiduese për studentët, fakultetin dhe stafin në një mjedis pjesëmarrës dhe vetëqeverisës. Duke u bazuar në traditën e punës ekipore ndërmjet studentëve, fakultetit, stafit dhe administratorëve, UBT pèrfshirè edhe degèn nè Ferizaj është e përkushtuar të rrisë pjesëmarrjen e saj si një anëtar aktiv i komunitetit duke ofruar mundësi mësimi të nxitura nga përsosmëria në mësimdhënie,hulumtime shkencore dhe inovacion, ndërveprimi intelektual dhe kreativiteti. Kolegji UBT pèrfshirè edhe degèn nè Ferizaj është një qendër e shquar e veprimtarisë intelektuale dhe kulturore në Kosovë, duke përmirësuar cilësinë e jetës përmes aftësive, njohurive, përvojës dhe angazhimit të stafit, studentëve dhe të diplomuarve të saj. Kolegji UBT pèrfshirè edhe degèn nè Ferizaj do të jetë një kontribuues kryesor për rritjen dhe zhvillimin strategjik të Kosovës dhe rajonit. Gjithashtu, Kolegji UBT pèrfshirè edhe degèn nè Ferizaj do t'i shërbejë Kosovës dhe rajonit, duke përgatitur liderë për shekullin e 21-të me një pikëpamje globale dhe aftësitë e nevojshme për avancimin arsimor, social, ekonomik, politik, mjedisor dhe kulturor.

Kolegji UBT është ndërtuar mbi përvojën e Institutit të Inxhinierisë dhe Menaxhimit të Ndërmarrjeve (IEME). Kolegji është licencuar për të funksionuar si bartës privat i arsimit të lartë nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë nr. 808/02-1, datë. 18.10.2004. Filozofia e institucionit ka qenë ofrimi i programeve konkurruese në arsim që do ta bazonin mësimdhënien në kërkesat e tregut dinamik të punës dhe praktikat ndërkombëtare. UBT është e drejtuar nga kërkesa e tregut dinamik të punës duke ofruar fillimisht programe inovative në mekatronikë dhe robotikë ku mendon se mund të kontribuojnë në zhvillimin afatgjatë ekonomik dhe social të Kosovës.Pastaj me konsolidimin Institucional ndër vite ofron shumë programe tjera studimore pikrisht për këtë qëllim. Orientimi i studentëve në programet studimore të Kolegjit UBT është i balancuar ndërmjet 5 fushave të gjera: (1) TIK, matematikë dhe shkenca natyrore (2) Inxhinieri, prodhim dhe ndërtim,dizajn dhe planifikim hapsinor (3) shkenca sociale (4) Shkenca biokimike-mjekësore dhe (5) Shkencat e Jetës. Degët rajonale të UBT-së si dega Ferizaj përfshihen në këtë plan duke ndjekur objektivat e përgjithshme institucionale.

Qeverisja e Kolegjit UBT-së pèrfshirè edhe degèn nè Prizren rregullohet me Statutin e institucionit. Si bartës privat i arsimit të lartë, rregulloret statutore të UBT-së u përgjigjen

kërkesave dhe praktikave të bazuara në Ligjin për Arsimin e Lartë, Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Bartësve Privatë të Arsimit të Lartë (UPAL), Udhëzimin Administrativ për Licencimin e BPAL, Udhëzimin Administrativ për Regjistrimin e Bizneseve të Ministrisë së Tregtisë dhe Punësimit, Ligji i punès nga Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe sè fundmi edhe Ligji Nr. 08/L-110 për agjencinè e Kosovès për akreditim.

Kolegji UBT dega nè Ferizaj është pjesë e ekosistemit më të gjerë të UBT-ë. Produktet dhe shërbimet e saj kryesore lidhen me (i) mësimëdhënien dhe mësimënxënien në arsimin e lartë, hulumtimin shkencor dhe inovacionin, (ii) akademinë ekzekutive për zhvillim profesional, (iii) qendrën e formimit profesional dhe (iv) shërbimet.

Sot Kolegji UBT dega nè Ferizaj ka 3 njësi akademike përkatësisht fakultete:

| **Shkurtesa** | **Fakulteti** |
|---|---|
| **MBE** | Fakulteti i Menaxhmentit, Biznesit dhe Ekonomisë |
| **SHKI** | Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinierisë Kompjuterike |
| **APH** | Fakulteti i Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor |

Ofrimi i aktiviteteve të edukimit dhe trajnimit janë kujdesur dhe përshtatur për të përmbushur kërkesat e zhvillimeve bashkëkohore të aplikimit të tyre industri dhe shoqëri. Kolegji UBT operon në disa lokacione si Kampuse dhe degë nëpër Kosovë, si dhe zyra dhe pika kontakti edhe jashtë Kosovës:

| | Kampuset dhe zyrat | Lokacioni |
|---|---|---|
| 1 | Kampus UBT Prishtina | Prishtina |
| 2 | Kampus UBT Innovation | Lipjan |
| 3 | Kampusi UBT Prizren | Prizren |
| 4 | Kampusi UBT Ferizaj | Ferizaj |
| 5 | Kampusi UBT Peja | Peja |
| 6 | Kampusi UBT Gjilan | Gjilan |
| 7 | UBT Austria Office | Vienna |
| 8 | UBT Hungary Office | Budapest |
| 9 | International University Association UBT-Nova Univerza | Ljubljana |

Po ashtu synohet edhe krijimi i grupit të përbashkët ndërkombëtar për rritjen e ndikimit të studiuesve vendor në zhvillimin ndërkombëtar përmes projekteve dhe mobiliteteve të stafit

akademik dhe studentëve si Komisionit Evropian Erasmus Exchange (ERASMUS), projekteve nga ERASMUS, ERASMUS+, COST EU (COST| European Cooperation in Science and Technology), Central European Exchange Program for University Studies (CEEPUS), programeve TEMPUS, projekteve SIGMA etj. si dhe përmes përmirësimit të infrastrukturës ekzistuese dhe zhvillimit të infrastrukturës së re për të mbështetur hulumtimin shkencor dhe inovacionin.

Me qëllim të përmbushjes në plotni të objektivës strategjike "Zhvillimi i Hulumtimit, Inovacionit dhe Përgjegjësisë Sociale", Kolegji UBT përfshirë edhe degën në Ferizaj ka krijuar edhe spin off-et e mëposhtme:

| Emri | Përshkrimi |
|---|---|
| **Quality Kosova** | Kosovo Association for Management – member of International Project Management Association and European Organisation for Quality |
| **CA – CASE** | Kosovo Association for Control, Automation and Systems Engineering – member of International Federation of Automation and Control |
| **KA – SIM** | Kosovo Association for Modelling and Simulation – Member of EUROSIM European Federation of Simulation Associations |
| **KAAAF** | Kosovo Association for Accounting, Auditing and Finance |
| **IES** | Intellectual Excellence Service |
| **UBT ADRC** | UBT Academic and Development Regional Centres |
| **IFC** | International Professional Certification and Evaluation |

## 1.2. RREGULLORJA PËR HULUMTIME SHKENCORE DHE INOVACION

Me qëllim të plotësimit të infrastrukturës ligjore dhe rregullimit të çështjeve dhe proceduarve që kanë të bëjnë me organizimin e veprimtarisë hulumtuese-shkencore dhe inovative të stafit akademik dhe studentëve, Kolegji UBT përfshirë edhe degën në Ferizaj ka nxjerrë rregulloren për Hulumtime Shkencore dhe Inovacion. Rregullorja përkufizon rregullat, procedurat dhe dokumentet e tjera shoqëruese për organizimin e veprimtarisë hulumtuese-shkencore dhe inovacionit të stafit akademik dhe studentëve konform Statutit të Kolegjit UBT përfshirë edhe degën në Ferizaj.

Në mënyrë specifike, me këtë Rregullore rregullohen:

1. Aktivitetet e veprimtarisë hulumtuese-shkencore dhe inovacionit në Kolegj.

2. Organizimi i veprimtarisë hulumtuese-shkencore dhe inovacionit.

3. Të drejtat dhe detyrimet e organeve të Kolegjit dhe stafit akademik si dhe studentëve pjesëmarrës në veprimtarinë hulumtuese-shkencore dhe inovacion.

4. Përgjegjësitë e zyrës për mbështetjen e hulumtimeve shkencore dhe inovacion.

5. Financimin e veprimtatrisë hulumtuese-shkencore dhe aplikative;inovacionin etj.

## 1.3. QËLLIMI I PLANIT STRATEGJIK PËR HULUMTIME SHKENCORE DHE INOVACION

Me anë të këtij plani strategjik, Kolegji UBT përfshirë edhe degën në Ferizaj dëshmon përgjegjësinë institucionale për të kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të vendit përmes ofrimit të aktiviteteve hulumtuese-shkencore dhe inovacionit si dhe shërbimeve në dobi të tij, mirëqenies së shoqërisë dhe vlerave të tjera. Ky plan strategjik shërben si një udhëzues për vendimmarrje lidhur me iniciativat institucionale, shpërndarjen e burimeve financiare e njerëzore, varësisht nga prioritetet, qëllimet dhe politikat e institucionale. Kolegji UBT përfshirë edhe degën në Ferizaj mbështet në vazhdimësi krijimtarinë e hulumtuese-shkencore dhe inovative të stafit akademik dhe studentëve si dhe do të vazhdoj të mbështesë edhe në të ardhmën dhe të krijoi një mjedis të përshtatshëm dhe të qëndrueshëm që frymëzon hulumtuesit për punë mëtejshme hulumtuese-shkencore dhe inovacion.

Parimet e Kartës Evropiane për hulumtuesit dhe Kodi i Sjelljes për rekrutimin e hulumtuesëve, të hartuar nga Komisioni Evropian në 2005, Ligji Nr. 04/L-135 për veprimtari kërkimore-shkencore i Republikës së Kosovës shtrojnë nevojën që institucionet e arsimit të lartë dhe institucionet tjera hulumtuese të hartojnë planin strategjik për hulumtime shkencore dhe inovacion.

## 1.4. MISIONI DHE VIZIONI I KOLEGJIT UBT

Kolegji UBT përfshirë edhe degën në Ferizaj ofron një qasje akademike e cila është dinamika dhe prirjet e saj inovative të cilat janë në hap me trendin teknologjik të shekullit XXI. Kolegji UBT përfshirë edhe degën në Ferizaj krijon terren të përshtatshëm dhe i jep mundësinë studentëve, fakulteteve dhe stafit të kenë një mjedis vetëqeverisës. UBT përfshirë edhe degën në Prizren ka krijuar një mjedis të përshtatshëm për bashkëpunim dhe ndërveprim të ngushtë mes studentëve,

stafit të fakultetit dhe administratorëve. UBT përfshirë edhe degën në Ferizaj është zotuar të zhvillojë veprimtarinë e saj si një anëtar aktiv i komunitetit, duke krijuar mundësi për mësimdhënie, hulumtim, ndërveprim dhe kreativitet mes intelektualëve.Kolegji UBT përfshirë edhe degën në Ferizaj është institucion i njohur dhe i shquar në veprimtarinë intelektuale dhe kulturore në Kosovë, duke përmirësuar cilësinë e jetës në shkallë rajonale përmes aftësive, njohurisë, përvojës, dhe angazhimit të fakulteteve, stafit, studentëve dhe alumnit.Kolegji UBT përfshirë edhe degën në Ferizaj është një ndër institucionet më të mira të arsimit të lartë në Kosovë, i zotuar për të vënë në zbatim metodat më të përparuara të mësimdhënies, mësimnxënies dhe hulumtimit shkencor dhe inovacionit në një mjedis ku i jepet një rëndësi e veçantë studentit përmes zbatimit të një qasje multidisiplinare, e cila do të kontribuojë në ekonomi në zhvillimin shoqëror dhe kulturor të Kosovës dhe më gjerë.

Kolegji UBT përfshirë edhe degën në Ferizaj është themeluar mbi disa vlera thelbësore:

- Krijimi i mjedisit të përshtatshëm për punë dhe studim.
- Mjedis dinamik i cili nxit zhvillimin në nivel individual dhe atë professional.
- Institucioni merret si pikë referimi për arsye se mbart në vetvete praktikat më të mira ndërkombëtare dhe standardet më të larta të cilësisë.
- Qendër e cila është model i përsosmërisë për sa i përket mësimdhënies, mësimënxënies, hulumtimit shkencor dhe inovacionit.
- Veprimtaria e saj zhvillohet në përputhje më kërkesat e palëve të interesuara dhe komunitetit.

## 1.5. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE PËR HULUMTINIM SHKENCOR DHE INOVACIONIN

Kolegji UBT përfshirë edhe degën në Ferizaj, në veprimtarinë e hulumtimit shkencor dhe inovacionit synon të arrijë këto objektiva të përgjithshme në periudhën 2025 - 2030:

- Përmirësimi i infrastrukturës për hulumtime shkencore dhe inovacion.
- Nxitja e veprimtarisë hulumtuese-shkencore dhe inovacion.
- Rritja e numrit të hulumtimeve shkencore dhe inovacionit.
- Funksionalizimin e Instituteve dhe qendrave të hulumtimit ose ekselencës.

- Rritjen e projektet hulumtuese-shkencore dhe bashkëpunimin në hulumtime shkencore dhe inovacion.
- Përmirësimin i cilësisë së hulumtimit shkencor dhe inovacionit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.
- Promovimi dhe dukshmëria e veprimtarisë hulumtuese-shkencore dhe inovacionit.
- Gjenerimin e të hyrave financiare në lidhje me hulumtimet e kryera nga palët e treta dhe transferimin e njohurive për qëllime komerciale.
- Aplikimin e standardeve të larta për arsimin e lartë si përgjigje ndaj nevojave të tregut dinamik të punës dhe sfidave të reja të shoqërisë bashkohore.
- Angazhimin e studentëve dhe profesorëve me rezultate më të larta shkencore në fushat interdisiplinare në implementimin e strategjisë për veprimtarinë hulumtuese-shkencore dhe inovative në Kolegjin UBT përfshirë edhe degën në Ferizaj.
- Vendosjen transparente të mundësive për të mësuar gjatë gjithë jetës për stafin akademik dhe hulumtuesit shkencor duke nënkuptuar diversitetin dhe aspektin gjinor në Kolegjin UBT përfshirë edhe degën në Ferizaj.

Ndërsa objektiva specifike janë:

- Përmirësimi i infrastrukturës për hulumtime shkencore dhe inovacion.
- Nxitja e veprimtarisë hulumtuese-shkencore dhe inovacionit.
- Funksionalizimi i instituteve dhe qendrave hulumtuese ose ekselencës.
- Rritja e numrit të hulumtimeve shkencore dhe inovacionit.

## 1.6 REZULTATET NGA IMPLEMENTIMI I PLANIT STRATEGJIK PËR HULUMTIME SHKENCORE DHE INOVACION

Kolegji UBT përfshirë edhe degën në Ferizaj në kuadër të planit strategjik për veprimtarinë hulumtuese-shkencore dhe inovacion ka paraparë edhe rezultatet e objektivave kryesore të kësaj strategjie:

- **REZULTATI 1.** Përmirësimi i infrastrukturës për hulumtime shkencore dhe inovacion.
- **REZULTATI 2.** Nxitja e veprimtarisë hulumtuese-shkencore dhe inovacionit.
- **REZULTATI 3.** Funksionalizimi i instituteve dhe qendrave hulumtuese ose ekselencës.
- **REZULTATI 4.** Rritja e numrit të hulumtimeve shkencore dhe inovacionit.

Lidhja ndërmjet hulumtimit shkencor, arsimit dhe shoqërisë do tё përforcohet dhe do të zhvillohet me iniciativa të ndryshme. Për më shumë, veprimtaria hulumtuese-shkencore dhe inovacioni në Kolegjin UBT pёrfshirë edhe degёn nё Ferizaj do të ketë një shtrirje të gjerë ndërdisiplinare dhe rezultatet e hulumtimeve shkencore do të kontribuojnë në zhvillimin shoqëror, për të cilin shpesh kërkohet një qasje përtej kufijve kombëtar. Të kuptuarit e elementeve dhe forcave komplekse brenda natyrës dhe shoqërisë kërkon ekzaminim nga perspektiva e disiplinave të shumta. Sfidat kryesore të shoqërisë rrallëherë mund të adresohen duke përdorur gjetjet vetëm me një disiplinë shkencore, prandaj Kolegji UBT pёrfshirë edhe degёn nё Ferizaj synon që nëpërmjet multidisiplinaritetit të krijon sinergji dhe zhvillim të mundësive dhe ideve krijuese.

Duke e marrë parasysh se veprimtaria hulumtuese-shkencore dhe inovacioni është tejet i rëndësishëm për shoqërinë, për arritjen e këtij rezultati Kolegji UBT pёrfshirë edhe degёn nё Ferizaj synon të realizoj aktivitetet si në vijim:

1.1. Krijimi dhe botimi i revistës shkencore.

1.2. Qasja në databazat ndërkombëtare.

1.3. Qasja në sistemin anti-plagjiat.

1.4. Sigurimi i liçencave për programe softwerike.

1.5. Kompletimi i laboratoreve me pajisje të nevojshme.

**REZULTATI 1.** Përmirësimi i infrastrukturës për hulumtime shkencore dhe inovacion

| **Aktivitetet** | **Përshkrim i aktiviteteve** | **Treguesi i performancës** |
|---|---|---|
| **Aktiviteti 1.1. Krijimi dhe botimi i revistës shkencore** | Kolegji UBT pёrfshirë edhe degёn nё Ferizaj do të krijoi revistën shkencore multidisiplinare me recension ndërkombëtar, e cila do të botohet nga Kolegji UBT pёrfshirë edhe degёn nё Ferizaj.<br>Për botimin e kësaj reviste Kolegji do të caktoi komisione të caktuara, të cilat do të merren me të gjitha | 1. Revista e krijuar dhe e publikuar. |

| | | |
|---|---|---|
| | procedurat e botimit të saj duke përfshirë emrin, bordin, recenzentët,etj.<br>Kolegji UBT përfshirë edhe degën në Ferizaj gjithashtu do të promovoi këtë revistë edhe në nivel ndërkombëtar nëpërmjet bashkëpunimeve ndërkombëtare, në mënyrë që në këtë revistë të publikohen punime shkencore relevante nga hulumtues vendor e ndërkombëtarë. | |
| **Aktiviteti 1.2. Qasja në databazat ndërkombëtare** | Kolegji UBT përfshirë edhe degën në Ferizaj në përputhje me nevojat dhe kërkesat e stafit akademik, do të vazhdoi qasjen në databaza ndërkombëtare si:<br>EBSCO, J-Store, Springer, Elsevier etj. | 1. Përdorimi i databazave ndërkombëtare. |
| **Aktiviteti 1.3. Qasja në sistemin anti-plagjiat** | Kolegji UBT përfshirë edhe degën në Ferizaj do të vazhdoi qasjen në sistemet anti-plagjiat (Turnitin), si dhe zhvillimin dhe blerjen e sistemeve të reja. | 1. Përdorimi i sistemit anti-plagjiat (Turnitin). |
| **Aktiviteti 1.4. Sigurimi i liçencave për programe softwerike** | Kolegji UBT përfshirë edhe degën në Ferizaj do të vazhdoi qasjen e përdorimit të liçencave për programet softverike statistikore (SPSS, MATLAB, etj.) si dhe zhvillimin dhe blerjen e sistemeve të reja. | 1. Përdorimi i programeve softwerike. |
| **Aktiviteti 1.5. Kompletimi i laboratoreve me pajisje të nevojshme** | Të gjitha laboratoret në Kolegjin UBT përfshirë edhe degën në Ferizaj do të vazhdojnë të kompletohen me të gjitha pajisjete nevojshme laboratike në programet studimore ku ato aplikohen. | 1. Blerja e pajisjeve dhe përdorimi i tyre. |

**REZULTATI 2. Nxitja e veprimtarisë hulumtuese-shkencore dhe inovacionit**

Kolegji UBT pèrfshirë edhe degèn nè Ferizaj do të vazhdojë të zhvilloj aktivitetin e tij duke e stimuluar veprimtarinë hulumtuese-shkencore dhe inovacionin, duke i mbështetur edhe financiarisht me qëllim të realizimin të tyre. Për të optimizuar suksesin tonë në këtë fushë,modeli ynë financiar duhet të sinkronizohet për të mundësuar aktivitetin hulumtues-shkencor dhe inovacionin në nivelin më të lartë.

Për arritjen e këtij rezultati Kolegji UBT pèrfshirë edhe degèn nè Ferizaj synon të realizoj aktivitetet si në vijim:

2.1. Rritja e buxhetit për veprimtarinë hulumtuese-shkencore dhe inovacion.

2.2. Mbështetja financiare për botimin e librave për secilin program studimor.

2.3. Mbështetja financiare për punime shkencore të publikuara në Web of Science (WOS) dhe SCOPUS.

2.4. Mbështetja financiare për pjesëmarrje në konferenca shkencore ndërkombëtare.

2.5. Mbështetja financiare për projekte të vogla shkencore.

2.6. Ndarja e çmimit "Hulumtuesi i vitit".

2.7. Ndarja e çmimit "Punimi shkencor më i mirë i vitit"

2.8. Organizimi i aktiviteteve shkencore: konferenca shkencore, trajnime, seminare, punëtori,simpoziume, tryeza shkencore etj.

2.9. Organizimi i koncerteve, ekspozitave individuale dhe kolektive vendore dhe ndërkombëtare.

**REZULTATI 2.** Nxitja e veprimtarisë hulumtuese-shkencore dhe inovacionit

| Aktiviteti | Përshkrimii aktivitetit | Treguesi i performancës |
|---|---|---|
| **Aktiviteti 2.1. Rritja e buxhetit për veprimtarinë hulumtuese-shkencore dhe inovacion.** | Kolegji UBT pèrfshirë edhe degèn nè Ferizaj çdo vit do të rritë buxhetin për mbështetje financiare për publikimin e punimeve shkencore, ku stafi akademik do të financohet | 1. Financimi i 2-3 punimeve shkencore për secilin staf akademik. |

| | | |
|---|---|---|
| | për publikimeve të 2-3 punime shkencore brenda vitit kalendarik. | |
| **Aktiviteti 2.2. Mbështetja financiare për botimin e librave për secilin program studimor.** | Kolegji UBT përfshirë edhe degën në Ferizaj do të financoi botimin e librave të stafit akademik për secilin program studimor. | l. Numri i librave të botuara. |
| **Aktiviteti 2.3. Mbështetja financiare për punime shkencore të publikuara në Web of Science (WOS) dhe SCOPUS.** | Kolegji UBT përfshirë edhe degën në Ferizaj do të financoi stafin akademik për publikimin e punimeve shkencore në revista shkencore ndërkombëtare, cilësore në databazat WEB OF SCIENCE dhe në SCOPUS (Q1 dhe Q2). | 1. Numri i punimeve shkencore të publikuara. |
| **Aktiviteti 2.4. Mbështetja financiare për pjesëmarrje në konferenca shkencore ndërkombëtare.** | Kolegji UBT përfshirë edhe degën në Ferizaj mbështet financiarisht stafin akademik për pjesëmarrje në konferenca shkencore ndërkombëtare. | 1. Nga 1 konferencë për secilin staf akademik.<br>2. Numri i konferencave shkencore ndërkombëtare të financuara. |
| **Aktiviteti 2.5. Mbështetja financiare për projekte të vogla shkencore.** | Kolegji UBT përfshirë edhe degën në Ferizaj ofron mbështetje financiare për projekte të vogla shkencore për stafin akademik.<br>Brenda një viti kalendarik Mbështetet nga 1 projekt për secilin program studimor. | 1.Nga 1 projekt për secilin program studimor.<br>2. Numri i projekteve të vogla shkencore të financuara. |
| **Aktiviteti 2.6. Ndarja e çmimit "Hulumtuesi i vitit"** | Çdo vit Kolegji UBT përfshirë edhe degën në Ferizaj do të shpall thirrje për ndarjen e çmimit "Hulumtuesi i vitit" | 1. Nga 1 çmim për secilin program studimor.<br>2. Numri i çmimeve të ndara. |
| **Aktiviteti 2.7. Ndarja e çmimit "Punimi shkencor më i mirë i vitit"** | Çdo vit Kolegji UBT përfshirë edhe degën në Ferizaj do të shpall thirrje publike ndarjen e çmimit "Punimi shkencor më i mirë i vitit" | 1. Nga 1 çmim për secilin program studimor.<br>2. Numri i çmimeve të ndara. |
| **Aktiviteti 2.8. Organizimi i aktiviteteve shkencore: konferenca shkencore, trajnime, seminare, punëtori,simpoziume, tryeza shkencore etj.** | Kolegji UBT përfshirë edhe degën në Ferizaj do të vazhdoi të organizoi aktivitete shkencore si: konferenca shkencore, trajnime, seminare, | 1. Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara.<br>2. Numri i pjesëmarrësve. |

| | | |
|---|---|---|
| | punëtori,simpoziume, tryeza shkencore etj. | |
| **Aktiviteti 2.9 Organizimi i koncerteve, ekspozitave individuale dhe kolektive vendore dhe ndërkombëtare.** | Kolegji UBT përfshirë edhe degën në Ferizaj në kuadër të programeve studimore ku veprimtaria hulumtuese dhe inovative zhvillohet përmes artit, studentët e këtyre programeve dhe stafi akademik do të vazhdojnë të organizojnë koncerte dhe ekspozita individuale dhe kolektive si dhe koncertin semestral në fund të çdo semestri dhe do të jetë e hapur edhe për publikun e gjerë. | l. Numri i koncerteve dhe ekspozitave të organizuara.<br>2. Koncerti semestral.<br>3. Numri i pjesëmarrësve. |

**REZULTATI 3. Funksionalizimi i instituteve dhe qendrave hulumtuese ose ekselencës**

Me vazhdimin e funksionalizimit të institutiteve dhe qendrave hulumtuese ose ekselencës të ofrohen mundësitë për burime shtesë të financimit, si dhe të krijohen bashkëpunime me institutet kombëtare dhe ndërkombëtare, industrinë dhe institucionet tjera private dhe publike në realizimin e hulumtimeve aplikative dhe projekteve shkencore për nevoja të tyre.

Duke e marrë parasysh se planifikimi i mirë dhe një sistem i menaxhimit efektiv financiar është faktor kyç në zhvillimin e hulumtimit shkencor dhe inovacionit të një institucioni, për arritjen e këtij rezultati Kolegji UBT përfshirë edhe degën në Ferizaj synon të realizoj aktivitetet si në vijim:

3. l. Rritja e fondeve nga shërbimet për industrinë dhe institucioneve tjera private dhe publike.

3.2. Rritja e bashkëpunimeve me institute dhe qendra hulumtuese kombëtare dhe ndërkombëtare.

3.3. Rritja e bashkëpunimeve me industrinë në realizimin e hulumtimeve aplikative.

3.4. Rritja e bashkëpunimeve me industrinë në realizimin e projekteve hulumtuese-shkencore.

**REZULTATI 3.** Funksionalizimi i Instituteve dhe qendrave hulumtuese ose ekselencës

| Aktiviteti | Përshkrimi i aktivitetit | Treguesi i performances |
|---|---|---|
| **Aktiviteti 3.1. Rritja e fondeve nga shërbimet për** | Kolegji UBT përfshirë edhe degën në Ferizaj nëpërmjet | l. Fondet e fituara-realizuara. |

| | | |
|---|---|---|
| **industrinë dhe institucioneve tjera private dhe publike.** | Instituteve dhe qendrave të hulumtimit ose ekselencës do të vazhdoi dhe do të rrisë gjenerimin e fondeve duke realizuar hulumtime shkencore dhe inovacion për nevojat e industrisë dhe institucioneve tjera private dhe publike. Ky aktivitet do të ndikojë në rritjen e buxhetit për hulumtime shkencore dhe inovacion. | |
| **Aktiviteti 3.2. Rritja e bashkëpunimeve me institute dhe qendra hulumtuese kombëtare dhe ndërkombëtare** | Kolegji UBT përfshirë edhe degën në Ferizaj nëpërmjet Instituteve dhe qendrave të hulumtimit ose ekselencës do të vazhdoi dhe do të rrisë bashkëpunimin me Institutet dhe qendrat hulumtuese brenda vendit siç janë: IKSHPK – Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publik, Instituti Bujqësor i Kosovës, etj. si dhe me institute dhe qendra hulumtuese ndërkombëtare. | 1. Numri i bashkëpunimeve të realizuara. |
| **Aktiviteti 3.3. Rritja e bashkëpunimeve me industrinë në realizimin e hulumtimeve aplikative** | Kolegji UBT përfshirë edhe degën në Ferizaj nëpërmjet Instituteve dhe qendrave të hulumtimit ose ekselencës do të vazhdoi dhe do të rrisë bashkëpunimin me industrinë | 1. Numri i bashkëpunimeve të realizuara. |

| | | |
|---|---|---|
| | për realizimin e projekteve hulumtuese aplikative sipas nevojave të tyre. | |
| **Aktiviteti 3.4 Rritja e bashkëpunimeve me industrinë në realizimin e projekteve hulumtuese-shkencore** | Kolegji UBT përfshirë edhe degën në Ferizaj nëpërmjet Instituteve dhe qendrave të hulumtimit ose ekselencës do të vazhdoi dhe do të rrisë bashkëpunimin me industrinë në veprimtarinë e tij hulumtuese-shkencore dhe inovacion. | l. Numri i bashkëpunimeve të realizuara. |

**REZULTATI 4. Rritja e numrit të hulumtimeve shkencore dhe inovacionit**

Një element i rëndësishëm i strategjisë së Kolegjit UBT përfshirë edhe degën në Ferizaj do të jetë realizimi i aktiviteteve të përbashkëta shkencore nga stafi akademik me studiues të tjerë vendor dhe ndërkombëtar, student dhe me një komunitet më të gjerë. Me bashkëpunimet e synuara do të ndërtohen rrjete të reja hulumtuese-shkencore dhe inovative për të përditësuar njohuritë ekzistuese dhe për të gjeneruar njohuri të reja.

Bashkëpunimet hulumtuese-shkencore dhe inovative të kësaj natyre paraqesin mundësi strategjike për të përmirësuar shkallën, cilësinë dhe ndikimin e veprimtarisë hulumtuese-shkencore dhe inovacionin. Nëpërmjet këtyre bashkëpunimeve realizohen përfitime të shumta ku hulumtuesit tone si stafi akademik dhe studentët do të ekspozohen ndaj perspektivave të ndryshme. Vazhdimi i partneriteteve strategjike me studiuesit ndërkombëtar dhe krijimi i partneriteteve të reja do të sjellin përvoja të reja për Kolegjin në përgjithësi dhe përfitime për programet studimore në veçanti. Për arritjen e këtij rezultati Kolegji UBT përfshirë edhe degën në Ferizaj synon të realizoj aktivitetet si në vijim:

4.1. Numri i punimeve shkencore të publikuara nga stafi akademik.

4.2. Numri i pjesëmarrjes së stafit akademik në konferenca shkencore ndërkombëtare.

4.3. Numri i projekteve të vogla shkencore të financuara nga Kolegji UBT përfshirë edhe degën në Ferizaj dhe të realizuara nga stafi akademik dhe studentët.

4.4. Numri i librave të botuara nga stafi akademik.

4.5. Numri i pjesëmarjes së stafit akademik në aktivitete shkencore: konferenca shkencore, trajnimeve,seminareve, punëtori, simpoziume, tryeza shkencore.

4.6. Realizimi i punës hulumtuese-shkencore në bashkëpunim me universitete kombëtare.

4.7. Realizimi i punës hulumtuese-shkencore në bashkëpunim me universitetet ndërkombëtare.

4.8. Realizimi i punës hulumtuese-shkencore në bashkëpunim me kolegët e brendshëm.

4.9. Realizimi i punës hulumtuese-shkencore në bashkëpunim me studentët.

4.10. Realizimi i hulumtimeve aplikative për nevoja të industrisë.

4.11. Përfshirja e punimeve shkencore në syllabuse të lëndëve mësimore.

4.12. Pjesëmarrja e stafit akademik dhe studentëve në aktivitete artistike ndërkombëtare si koncertet,festivalet, ekspozitat etj.

**REZULTATI 4.** Rritja e numrit të hulumtimeve shkencore dhe inovacionit

| Aktiviteti | Përshkrim i aktivitetit | Treguesi i performances |
|---|---|---|
| **Aktiviteti 4.1. Numri i punimeve shkencore të publikuara nga stafi akademik** | Zyra për hulumtime shkencore dhe inovacion do të krijoj databazën me qëllim të identifikimit të numrit të punimeve shkencore të stafit akademik. Databaza do të publikohet në web faqen zyrtare të Kolegjit UBT përfshirë edhe degën në Ferizaj dhe do të përditësohet vazhdimisht. | l. 80-90% e stafit akademik.<br>2. Krijmi i databazës.<br>3.Publikimi i databazës në webfaqen zyrtare të Kolegjit UBT përfshirë edhe degën në Ferizaj. |
| **Aktiviteti 4.2. Numri i pjesëmarrjes së stafit akademik në konferenca shkencore ndërkombëtare** | Zyra për hulumtime shkencore dhe inovacion do të krijoj databazën me qëllim të identifikimit të numrit të pjesëmarrjes së stafit akademik në konferenca | l. 50-60% e stafit akademik.<br>2. Krijmi i databazës.<br>3.Publikimi i databazës në webfaqen zyrtare të Kolegjit UBT përfshirë edhe degën në Ferizaj. |

| | | |
|---|---|---|
| | shkencore ndërkombëtare. Databaza do të publikohet në web faqen zyrtare të Kolegjit UBT për̀fshirë edhe degën në Ferizaj dhe do të përditësohet vazhdimisht. | |
| **Aktiviteti 4.3. Numri i projekteve të vogla shkencore të financuara nga Kolegji UBT për̀fshirë edhe degën në Ferizaj dhe të realizuara nga stafi akademik dhe studentët.** | Zyra për hulumtime shkencore dhe inovacion do të krijoj databazën e të dhënave të projekteve të vogla shkencore të financuara nga Kolegji UBT për̀fshirë edhe degën në Ferizaj dhe të realizuara nga stafi akademik dhe studentët. Databaza do të publikohet në web faqen zyrtare të Kolegjit UBT për̀fshirë edhe degën në Ferizaj dhe do të përditësohet vazhdimisht. | l. Numri i projekteve të realizuara.<br>2. Krijmi i databazës.<br>3.Publikimi i databazës në webfaqen zyrtare të Kolegjit UBT për̀fshirë edhe degën në Ferizaj. |
| **Aktiviteti 4.4. Numri i librave të botuara nga stafi akademik** | Zyra për hulumtime shkencore dhe inovacion do të krijoj databazën e të dhënave të librave të botuara nga stafi akademik i Kolegjit UBT për̀fshirë edhe degën në Ferizaj. Databaza do të publikohet në web faqen zyrtare të Kolegjit UBT për̀fshirë edhe degën në Ferizaj dhe do të përditësohet vazhdimisht. | 1. Numri i librave të botuara.<br>2. Krijmi i databazës.<br>3. Publikimi i databazës në webfaqen zyrtare të Kolegjit UBT për̀fshirë edhe degën në Ferizaj. |
| **Aktiviteti 4.5. Numri i pjesëmarjes së stafit akademik në aktivitete shkencore: konferenca shkencore, trajnimeve,seminareve, punëtori, simpoziume, tryeza shkencore** | Zyra për hulumtime shkencore dhe inovacion do të krijoj databazën e të dhënave të aktiviteteve shkencore të stafit akademik të Kolegjit UBT për̀fshirë edhe degën në Ferizaj. Databaza do të publikohet në web faqen zyrtare të Kolegjit UBT për̀fshirë edhe degën në Ferizaj dhe do të përditësohet vazhdimisht. | l. Numri stafit akademik pjesëmarrës.<br>2. Krijmi i databazës.<br>3. Publikimi i databazës në webfaqen zyrtare të Kolegjit UBT për̀fshirë edhe degën në Ferizaj. |
| **Aktiviteti 4.6. Realizimi i punës hulumtuese-** | Kolegji UBT për̀fshirë edhe degën në Ferizaj mbështetë | 1.20-30% e stafit akademik. |

| | | |
|---|---|---|
| **shkencore në bashkëpunim me universitete kombëtare** | realizimin e hulumtimeve shkencore dhe inovacionit, të cilat realizohen në bashkëpunim mes stafit akademik të UBT-së përfshirë edhe degën në Ferizaj dhe kolegëve të tyre nga universitetet vendore në Kosovë nëpërmjet hulumtimeve shkencore të përbashkëta. Po ashtu, zyra për hulumtime shkencore dhe inovacion do të krijoj databazën e të dhënave të këtyre bashkëpunimeve. Databaza do të publikohet në web faqen zyrtare të Kolegjit UBT përfshirë edhe degën në Ferizaj dhe do të përditësohet vazhdimisht. | 2.Numri i bashkëpunimeve të realizuara.<br>3.Krijmi i databazës.<br>4. Publikimi i databazës në webfaqen zyrtare të Kolegjit UBT përfshirë edhe degën në Ferizaj. |
| **Aktiviteti 4.7. Realizimi i punës hulumtuese-shkencore në bashkëpunim me universitetet ndërkombëtare** | Kolegji UBT përfshirë edhe degën në Ferizaj mbështetë realizimin e hulumtimeve shkencore dhe inovacionit, të cilat realizohen në bashkëpunim mes stafit akademik të UBT-së përfshirë edhe degën në Ferizaj dhe kolegëve të tyre nga universitetet ndërkombëtare nëpërmjet hulumtimeve shkencore të përbashkëta. Po ashtu, zyra për hulumtime shkencore dhe inovacion do të krijoj databazën e të dhënave të këtyre bashkëpunimeve. Databaza do të publikohet në web faqen zyrtare të Kolegjit UBT përfshirë edhe degën në Ferizaj dhe do të përditësohet vazhdimisht. | 1.20-30% e stafit akademik.<br>2.Numri i bashkëpunimeve të realizuara.<br>3.Krijmi i databazës.<br>4. Publikimi i databazës në webfaqen zyrtare të Kolegjit UBT përfshirë edhe degën në Ferizaj. |
| **Aktiviteti 4.8. Realizimi i punës hulumtuese-shkencore në bashkëpunim me kolegët e brendshëm** | Kolegji UBT përfshirë edhe degën në Ferizaj mbështetë realizimin e hulumtimeve shkencore dhe inovacionit, të cilat realizohen nga një grup | 1. 40-50% e stafit akademik.<br>2. Numri i bashkëpunimeve të realizuara. |

| | | |
|---|---|---|
| | profesorësh të UBT-së përfshirë edhe degën në Ferizaj. Zyra për për hulumtime shkencore dhe inovacion do të krijoj databazën e të dhënave të këtyre bashkëpunimeve. Databaza do të publikohet në web faqen zyrtare të Kolegjit UBT përfshirë edhe degën në Ferizaj dhe do të përditësohet vazhdimisht. | 3. Krijmi i databazës.<br>4. Publikimi i databazës në webfaqen zyrtare të Kolegjit UBT përfshirë edhe degën në Ferizaj. |
| **Aktiviteti 4.9. Realizimi i punës hulumtuese-shkencore në bashkëpunim me studentët** | Në kuadër të hulumtimeve shkencore dhe projekteve hulumtuese-shkencore dhe aplikative që realizohen nga stafi akademik i Kolegjit UBT përfshirë edhe degën në Ferizaj do të vazhdojnë të përfshihen edhe studentët në përputhje me kompetencën e tyre profesionale, në mënyrë që studentët të njihen me hulumtimin shkencorë. Në kuadër të procesit mësimor, studentët do të angazhohen edhe në projekte shkencore dhe aplikative.<br>Zyra për për hulumtime shkencore dhe inovacion do të krijoj databazën e të dhënave të këtyre bashkëpunimeve. Databaza do të publikohet në web faqen zyrtare të Kolegjit UBT përfshirë edhe degën në Ferizaj dhe do të përditësohet vazhdimisht. | 1. 40-50% e stafit akademik.<br>2. Numri i bashkëpunimeve të realizuara.<br>3. Krijmi i databazës.<br>4. Publikimi i databazës në webfaqen zyrtare të Kolegjit UBT përfshirë edhe degën në Ferizaj. |
| **Aktiviteti 4. 10. Realizimi i hulumtimeve aplikative për nevoja të industrisë** | Zyra për për hulumtime shkencore dhe inovacion, në bashkëpunim me Institutet dhe qendrat hulumtuese ose të ekselencës si dhe me stafin akademik, do të identifikoi industritë, të cilat janë tinteresuara për aplikuar hulumtimet dhe të cilat janë të | 1.40-50% e stafit akademik.<br>2. Numri i bashkëpunimeve të realizuara.<br>3.Krijmi i databazës<br>4.Publikimi i databazës në webfaqen zyrtare të Kolegjit UBT përfshirë edhe degën në Ferizaj. |

| | | |
|---|---|---|
| | gatshme të përkrahin financiarisht këto hulumtime. Zyra për për hulumtime shkencore dhe inovacion do të krijoj databazën e të dhënave të këtyre bashkëpunimeve. Databaza do të publikohet në web faqen zyrtare të Kolegjit UBT për̀fshirë̀ edhe degë̀n në̀ Ferizaj dhe do të përditësohet vazhdimisht. | |
| **Aktiviteti 4.11. Përfshirja e punimeve shkencore në syllabuse të lëndëve mësimore** | Stafi akademik do të përfshijnë punimet e tyre shkencore në përmbajtjen mësimore tëndëve mësimore - syllabuse nëselinin program studimor qëofron Kolegji UBT për̀fshirë̀ edhe degë̀n në̀ Ferizaj. Po ashtu, Zyra për për hulumtime shkencore dhe inovacion do të krijoj databazën e të dhënave të këtij aktiviteti. Databaza do të publikohet në web faqen zyrtare të Kolegjit UBT për̀fshirë̀ edhe degë̀n në̀ Ferizaj dhe do të përditësohet vazhdimisht. | 1.40-50% e stafit akademik.<br>2.Numri i bashkëpunimevepunimeve shkencore të përfshira nësyllabuse.<br>3.Krijmi i databazs<br>4.Publikimi i databazës në webfaqen zyrtare të Kolegjit UBT për̀fshirë̀ edhe degë̀n në̀ Ferizaj. |
| **Aktiviteti 4.12. Pjesëmarrja e stafit akademik dhe studentëve në aktivitete artistike ndërkombëtare si koncertet,festivalet, ekspozitat etj.** | Kolegji UBT për̀fshirë̀ edhe degë̀n në̀ Ferizaj për çdo vit do të mbështesë stafin akademik dhe studentët e programeve studimore në tëcilat zhvillohet veprimtari artistike për të marrë pjesë në aktivitete artistike ndërkombëtare si koncertet,festivalet, ekspozitat etj.<br>Po ashtu, Zyra për për hulumtime shkencore dhe inovacion do të krijoj databazën e të dhënave të këtyre aktiviteteve. Databaza do të publikohet në web faqen zyrtare të Kolegjit UBT për̀fshirë̀ edhe degë̀n në̀ | 1. 20-30% pjesëmarrja e stafit akademik.<br>2. 40-50% pjesëmarrja e studentëve.<br>3.Krijmi i databazs<br>4. Publikimi i databazës në webfaqen zyrtare të Kolegjit UBT për̀fshirë̀ edhe degë̀n në̀ Ferizaj. |

| | | |
|---|---|---|
| | Ferizaj dhe do të përditësohet vazhdimisht. | |

## 1.7 MONITORIMI DHE VLERËSIMI

Plani Strategjik për Hulumtime Shkencore dhe Inovacion është i nevojshëm për të shërbyer si një strukturë funksionale për përmirësimin, monitorimin dhe rishikimin hulumtimeve shkencore dhe inovacionit në Kolegjin UBT përfshirë edhe degën në Ferizaj.

Kolegji UBT përfshirë edhe degën në Ferizaj është do të bëjë monitorimin dhe përcjelljen e progresit të veprimtarisë hulumtuese-shkencore dhe inovacionit të stafit akademik dhe studentëve pjesëmarrës program të studimit si dhe korigjimet eventuale si rishikimin për të kthyer Objektivat e planifikuara në drejtimin e duhur, të bazuar në prova, dhe në përgjegjësi për rastet kur plani i veprimit nuk ështe duke funksionuar sipas parashikimeve.

Plani i monitorimit dhe vlerësimit do të zhvillohet në konsultim me palët kryesore të interesit brenda dhe jashtë Kolegjit dhe është i nevojshëm ndër të tjera për evidentimin e rezultateve të arritura, progresin ndaj synimeve të strategjisë dhe kërkesat e aktiviteteve të rishikuara.

Plani i monitorimit dhe vlerësimit, do të jetë fleksibil dhe i arsyeshëm, dhe do shërbejë për të ripërcaktuar, rishikuar dhe përmirësuar objektivat e planit strategjikë për veprimtarinë hulumtuese-shkencore dhe inovacion.

Plani i monitorimit dhe vlerësimit do të ketë indikatorët si matja e performances dhe rezultatet e pritura.

## 1.8 MATJA E PERFORMANCËS

- Rritja e numrit të stafit akademik në hulumtime shkencore dhe inovacion në të gjitha programet e synuara në shkallën 40-50% për periudhën 2025-2030.
- Rritja e numrit të punimeve shkencore të publikuara në revistat ndrkombëtare të indeksuara në Web of Science (WOS) dhe SCOPUS në shkallën 40-50% për periudhën 2025-2030.
- Rritjen e bashkëpunimi në fushën e hulumtimeve me Universitetet tjera për 20%.
- Rritja e bashkëpunimeve të Instituteve dhe qendrave të hulumtimit ose ekselencës me institute dhe qendra hulumtimi kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe me industrinë përmes bashkëpunimit të vazhdueshëm me bordet industriale dhe krijimi i bashkëpunimve të reja.

- Rritja e numrit të bashkëpunimeve të stafit akademik me kolegë të brenda Kolegjit UBT përfshirë edhe degën në Ferizaj, të jashtëm dhe studentë.
- Rritja e vëllimit dhe vlerës së hulumtimmeve shkencore dhe inovacionit në bashkëpunim me institucione ndërkombëtare në shkallën 40-50% për periudhën 2025-2030.
- Rangimi i Kolegjit UBT përfshirë edhe degën në Ferizaj nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar në platformën WEBOMETRICS në shkallën 40-50% më lartë për periudhën 2025-2030.

## 1.9 REZULTATET E PRITURA

Implementimi i këtij plani strategjik do të përmbushë në plotni misioni dhe vizioni e Kolegjit UBT përfshirë edhe degën në Ferizaj si:

- Kolegji UBT përfshirë edhe degën në Ferizaj siç njihet si një Institucion i Arsimit të Lartë i dalluar jo vetëm në mësimëdhënie por edhe në hulumtime shkencore dhe inovacion.
- Veprimtaria hulumtuese-shkencore dhe inovacioni të zhvillohen nëpërmjet Instituteve dhe qendrave hulumtuese ose ekselencës të krijuara për këtë qëllim.
- Kolegji UBT përfshirë edhe degën në Ferizaj do të jetë lider në vend sa i përket veprimtarisë hulumtuese-shkencore dhe inovacionit.
- Ndërlidhja e hulumtimit dhe inovacionit me industrinë për t'u angazhuar me mbështetjen aplikimit të hulumtimit dhe inovacionit, duke krijuar njohuri të reja dhe punësime të reja.
- Rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar në ngritjen e kapaciteteve të hulumtuese-shkencore dhe inovative.
- Rritja e përfshierjes së studentëve në hulumtime shkencore dhe inovacion me qëllim të arritjes së njohurive inovative për t’u përgatitur për tregun dinamik të punës.
- Të siguroi që njohuritë e arritura të pranohen edhe në arenën ndërkombëtare.

## Plani zhvillimor dhe financiar

| Nr. | Veprimi/aktiviteti | Periudha e implementimit | Buxheti 2025-2030 | Stafi/Përgjegjësit | | Produkti (Outputi) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | **1.Përmirësimi i infrastrukturës për hulumtime shkencore dhe inovacion** | | | | | |
| **1** | Aktiviteti 1.1. Krijimi dhe botimi i revistës shkencore | Krijimi 2025<br>Botimi çdo vit | | | Rektorati<br>Zyra per kerkime shkencore | 1. Vëllimet e publikuara |
| **2** | Aktiviteti 1.2. Qasja në databazat ndërkombëtare | Çdo vit<br>2025-2030 | | N/A | Rektorati<br>Zyra per kerkime shkencore<br>Zyra IT | 1. Përdorimi i databazave |
| **3** | Aktiviteti 1.3. Qasja në sistemin anti-plagjiat | Çdo vit<br>2025-2030 | | | Zyra per kerkime shkencore<br>Zyra IT | 1. Përdorimi i sistemit anti-plagjiat |
| **4** | Aktiviteti 1.4. Sigurimi i liçencave për programe softwerike | Çdo vit<br>2025-2030 | | | Rektorati<br>Zyra per kerkime shkencore<br>Zyra IT | 1. Përdorimi i programeve softwerike |
| **5** | Aktiviteti 1.5. Kompletimi i laboratoreve me pajisje të nevojshme | Çdo vit<br>2025-2030 | | | Rektorati<br>Zyra e financave<br>Fakultetet | 1. Blerja e pajisjeve dhe përdorimi i tyre |
| | **2. Nxitja e veprimtarisë hulumtuese-shkencore dhe inovacionit** | | | | | |
| **6** | Aktiviteti 2.1. Rritja e buxhetit për veprimtarinë hulumtuese-shkencore dhe inovacion. | Çdo vit<br>2025-2030 | | | Rektorati<br>Zyra e financave | 1. Financimi i 2-3 punimeve shkencore për secilin staf akademik. |
| **7** | Aktiviteti 2.2. Mbështetja financiare për botimin e librave për secilin program studimor | Çdo vit<br>2025-2030 | | | Prorektori per shkence<br>Keshilli i botimeve<br>Fakultetet | l. Numri i librave të botuara. |
| **8** | Aktiviteti 2.3. Mbështetja financiare për punime shkencore të publikuara në Web of Science (WOS) dhe SCOPUS | Çdo vit<br>2025-2030 | | | Zyra per kerkime shkencore<br>Grupi per kerkime shkencore | 1. Numri i punimeve shkencore të publikuara |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **9** | Aktiviteti 2.4. Mbështetja financiare për pjesëmarrje në konferenca shkencore ndërkombëtare | Çdo vit 2025-2030 | | | Zyra per kerkime shkencore Grupi per kerkime shkencore | 1. Numri i konferencave shkencore ndërkombëtare të financuara |
| **10** | Aktiviteti 2.5. Mbështetja financiare për projekte të vogla shkencore | Çdo vit 2025-2030 | | | Zyra per kerkime shkencore Grupi per kerkime shkencore | 1. Numri i projekteve të vogla shkencore të financuara |
| **11** | Aktiviteti 2.6. Ndarja e çmimit "Hulumtuesi i vitit" | Çdo vit 2025-2030 | | | Zyra per kerkime shkencore Grupi per kerkime shkencore | 1.Numri i çmimeve të ndara |
| **12** | Aktiviteti 2.7. Ndarja e çmimit "Punimi shkencor më i mirë i vitit" | Çdo vit 2025-2030 | | | Zyra per kerkime shkencore Grupi per kerkime shkencore | 1.Numri i çmimeve të ndara |
| **13** | Aktiviteti 2.8. Organizimi i aktiviteteve shkencore: konferenca shkencore, trajnime, seminare, punëtori,simpoziume, tryeza shkencore etj. | Çdo vit 2025-2030 | | | Rektorati<br><br>Zyra per kerkime shkencore Fakultetet | 1.Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara |
| **14** | Aktiviteti 2.9 Organizimi i koncerteve, ekspozitave individuale dhe kolektive vendore dhe ndërkombëtare. | Çdo vit 2025-2030 | | | Rektorati Fakultetet | l. Numri i koncerteve të organizuara.<br>2. Numri i ekspozitave të organizuara. |
| | **3. Funksionalizimi i instituteve dhe qendrave hulumtuese ose ekselencës** | | | | | |
| **15** | Aktiviteti 3.1. Rritja e fondeve nga shërbimet për industrinë dhe institucioneve tjera private dhe publike. | Çdo vit 2025-2030 | | | Rektorati Institutet dhe qendrat hulumtuese ose ekselencës | Fondet e fituara-realizuara |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **16** | Aktiviteti 3.2. Rritja e bashkëpunimeve me institute dhe qendra hulumtuese kombëtare dhe ndërkombëtare | Çdo vit 2025-2030 | | | Rektorati Institutet dhe qendrat hulumtuese ose ekselencës | l. Numri i bashkëpunimeve të realizuara. |
| **17** | Aktiviteti 3.3. Rritja e bashkëpunimeve me industrinë në realizimin e hulumtimeve aplikative | Çdo vit 2025-2030 | | | Rektorati Institutet dhe qendrat hulumtuese ose ekselencës Industria | l. Numri i bashkëpunimeve të realizuara. |
| **18** | Aktiviteti 3.4. Rritja e bashkëpunimeve me industrinë në realizimin e projekteve hulumtuese-shkencore | Çdo vit 2025-2030 | | | Rektorati Institutet dhe qendrat hulumtuese ose ekselencës Industria | l. Numri i bashkëpunimeve të realizuara. |
| | **4. Rritja e numrit të hulumtimeve shkencore dhe inovacionit** | | | | | |
| **19** | Aktiviteti 4.1. Numri i punimeve shkencore të publikuara nga stafi akademik | Çdo vit 2025-2030 | | | Zyra per kerkime shkencore Stafi akademik | 1.Databaza e publikuar në webfaqen zyrtare të Kolegjit UBT. |
| **20** | Aktiviteti 4.2. Numri i pjesëmarrjes së stafit akademik në konferenca shkencore ndërkombëtare | Çdo vit 2025-2030 | | | Zyra per kerkime shkencore Stafi akademik | 1.Databaza e publikuar në webfaqen zyrtare të Kolegjit UBT. |
| **21** | Aktiviteti 4.3. Numri i projekteve të vogla shkencore të financuara nga Kolegji UBT dhe të realizuara nga stafi akademik dhe studentët. | Çdo vit 2025-2030 | | | Zyra per kerkime shkencore Stafi akademik | 1.Databaza e publikuar në webfaqen zyrtare të Kolegjit UBT. |
| **22** | Aktiviteti 4.4. Numri i librave të botuara nga stafi akademik | Çdo vit 2025-2030 | | | Zyra per kerkime shkencore Stafi akademik | 1.Databaza e publikuar në webfaqen zyrtare të Kolegjit UBT. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **23** | Aktiviteti 4.5. Numri i pjesëmarjes së stafit akademik në aktivitete shkencore: konferenca shkencore, trajnimeve,seminareve, punëtori, simpoziume, tryeza shkencore | Çdo vit 2025-2030 | | | Zyra per kerkime shkencore Stafi akademik | 1.Databaza e publikuar në webfaqen zyrtare të Kolegjit UBT. |
| **24** | Aktiviteti 4.6. Realizimi i punës hulumtuese-shkencore në bashkëpunim me universitete kombëtare | Çdo vit 2025-2030 | | | Zyra per kerkime shkencore Stafi akademik | 1.Databaza e publikuar në webfaqen zyrtare të Kolegjit UBT. |
| **25** | Aktiviteti 4.7. Realizimi i punës hulumtuese-shkencore në bashkëpunim me universitetet ndërkombëtare | Çdo vit 2025-2030 | | | Zyra per kerkime shkencore Stafi akademik | 1.Databaza e publikuar në webfaqen zyrtare të Kolegjit UBT. |
| **26** | Aktiviteti 4.8. Realizimi i punës hulumtuese-shkencore në bashkëpunim me kolegët e brendshëm | Çdo vit 2025-2030 | | | Zyra per kerkime shkencore Stafi akademik | 1.Databaza e publikuar në webfaqen zyrtare të Kolegjit UBT. |
| **27** | Aktiviteti 4.9. Realizimi i punës hulumtuese-shkencore në bashkëpunim me studentët | Çdo vit 2025-2030 | | | Zyra per kerkime shkencore Stafi akademik | 1.Databaza e publikuar në webfaqen zyrtare të Kolegjit UBT. |
| **28** | Aktiviteti 4. 10. Realizimi i hulumtimeve aplikative për nevoja të industrisë | Çdo vit 2025-2030 | | | Zyra per kerkime shkencore Stafi akademik | 1.Databaza e publikuar në webfaqen zyrtare të Kolegjit UBT. |
| **29** | Aktiviteti 4.11. Përfshirja e punimeve shkencore në syllabuse të lëndëve mësimore | Çdo vit 2025-2030 | | | Zyra per kerkime shkencore Fakultetet<br><br>Stafi akademik | 1.Databaza e publikuar në webfaqen zyrtare të Kolegjit UBT |
| **30** | Aktiviteti 4.12. Pjesëmarrja e stafit akademik dhe studentëve në | Çdo vit 2025-2030 | | | Stafi akademik | 1.Databaza e publikuar në webfaqen zyrtare të Kolegjit UBT |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | aktivitete artistike ndërkombëtare si koncertet,festivalet, ekspozitat etj. | | | | | |